



Shuma e zakonshme e faturuar

Nëse merrni asistencë sipas politikës për asistencë financiare (FAP) të CoxHealth, spitali dhe klinikat* nuk duhet t'ju kërkojnë çmim më të lartë se shuma e zakonshme e faturuar (AGB) për individët të cilët kanë sigurim që i mbulon të njëjtat shërbime. Një pacient i pranueshëm për asistencë financiare konsiderohet të jetë "i ngarkuar" vetëm për shumën të cilën është personalisht përgjegjës për ta paguar, pas zbatimit të të gjitha zbritjeve (përfshirë zbritjet në dispozicion sipas FAP) dhe pagesave të sigurimeve.

CoxHealth përcakton shumën e zakonshme të faturuar duke shumëzuar çmimin bruto të spitalit të atij kujdesi me një ose më shumë përqindje të çmimeve bruto, të quajtur "përqindja AGB". Përqindja AGB llogaritet çdo vit duke pjesëtuar shumën e plotë të të gjitha detyrimeve të kërkuara nga spitali (përfshirë të pasiguruarit dhe Medicaid) të cilat janë lejuar nga sigurvezit shëndetësorë gjatë periudhës 12 mujore paraprake nga shuma e ngarkesave bruto të ndërlidhura me ato detyrime të kërkuara. Për këto qëllime, shuma e plotë e lejuar nga një sigurvez shëndetësor përfshin që të dyja, shumën që duhet të kompensohet nga sigurvezi dhe

shumën (nëse ka) që individi është personalisht përgjegjës për ta paguar në formë të bashkëpagesave, bashkësigurimit ose të tarifave të zbritura. Llogaritja e AGB kryhet çdo vit për çdo spital dhe klinikë.

Pasi të aprovohet e drejta për asistencë financiare, spitali do të kryejë zbritjen e asistencës financiare të aplikueshme të përshkruar në tabelën e të ardhurave për asistencë financiare dhe zbritje. Çdo shumë për të cilën ju detyroheni do të shqyrtohet për t'u siguruar se është më i vogël se përqindja e AGB. Nëse shuma e detyruar është më e madhe se shuma e lejuar nga AGB, do të kryhet një zbritje shtesë për ta zvogëluar atë në përqindjen e AGB.

Më poshtë është përqindja e AGB për klinikat dhe çdo spital të CoxHealth. Nëse keni pyetje në lidhje me llogaritjen e AGB, ju lutemi telefononi:

Barton County: 417-681-5100

Branson: 417-348-8930

Monett: 417-354-1118

Springfield: 417-269-0523

Klinikat: 417-269-4353 ose 417-875-3187

Ofruesi	Përqindja e zakonshme e shumës së faturuar (AGB)
Barton County Hospital	34.00%
Branson Hospital	24.67%
Monett Hospital	34.08%
Springfield Hospitals	28.34%
Klinikat*	53.00%

*Shiko **Shtojca 3** për listën e klinikave

Në fuqi më 11/2018